



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:269324

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05406910

AA.nr.544/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit V.R, Komuna e Kamenicës, kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, A.nr.2156/2018, të datës 14.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit V.R, Komuna e Kamenicës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2156/2018, i datës 14.06.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin, A.nr.2156/2018, të datës 14.06.2023, e ka hedhë poshtë si të palejueshme padinë A.nr.2156/18 të paditësit V.R, Komuna e Kamenicës, të ushtruar me datë 5 shtator 2018, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, me kërkesë për anulimin e vendimit Nr.07-05/1279 të datës 13.08.2018, pasi që kjo çështje juridike është e gjykuar me vendim të formës së prere.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit Halit Azemi avokat nga Gjilani, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit dhe aktvendimi i ankimuar të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje dhe të mirret vendim meritor.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktin Administrativ (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit Vullnet Ramadani me datë 5 shtator 2018 ka ushtruar padi në gjykatë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, me kërkesë për anulim të vendimit nr.07-05/1279 të datës 13.08.2018.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, pas vlerësimit të lejueshmërisë së padisë së paditësit, të njëjtën e ka hedhë poshtë si të palejuar duke i'u referuar dispozitës së nenit 166 par.2 dhe nenit 391 par.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Me arsyetim se me aktgjykimin A.nr.2156/18 të datës 13 prill 2021, gjykata ka aprovuar padinë e paditësit dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura. Meqenëse e paditura nuk kishte vendosur sipas vërejtjeve të gjykatës, paditësi me datën 01.08.2022 ka parashtruar kërkesë për njohjen e të drejtës në pension sipas skemës veteran i UÇK-së. Nga Sistemi për Menaxhimin e Lëndëve, gjykata ka gjetur së paditësi, për çështjen e njëjtë pranë kësaj gjykate kishte ushtruar edhe një padi tjetër nen shenjën A.nr.2152/21 kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Gjykata e shkallës së parë pasi analizojë të dy lëndët A.nr.2156/18 dhe A.nr.2125/21, gjeti së bëhet fjalë për çështjen e njëjtë, mirëpo meqenëse lënda A nr.2125/21, është proceduar më herët dhe e njëjta është vendosur me vendim të formës së prerë, atëherë gjykata vendosi ta hedhë poshtë padinë në këtë çështje për shkak të çështjes si çështje e gjykuar.

Prandaj, duke u bazuar në faktin se çështja e ngritur me padi përbën çështje të gjykuar me vendim të formës së prerë, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Sepse me dispozitën e nenit 166 par.2 të LPK-së, përcaktohet se: *“166.2 Gjykata gjatë gjithë procedimit të çështjes kujdeset sipas detyrës zyrtare se a mos është gjë e gjykuar çështja e ngritur me padi dhe nëse konstaton se procedura është iniciuar për kërkesën për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, padia duhet të hedhet poshtë si e palejueshme”*. Ndërsa me dispozitën e nenit 391 par.1 pika d) të LPK-së, përcaktohet se *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata)”*

Duke u bazuar në këto dispozita ligjore të lartcekura, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me të drejtë ka hedhë poshtë padinë e paditësit në këtë çështje juridiko-administrative, për shkak se kjo çështje juridike është gjë e gjykuar me vendim të formës së prerë. Prandaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në këtë çështje kontestuese nuk janë plotësuar kushtet për fillimin e konfliktit administrativ. Andaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të paditësit se nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar por nëse janë dy procedura për të cilën konkludon gjykata e shkallës së parë duhet ti bashkojë procedurat e jo të hedhe poshtë se kinse kjo çështje është e gjykuar me vendim të formës se prere. Për arsye se tani po ngatërrohen procedurat edhe në procedurën tjetër gjykata mundë të thirret në këtë aktvendim siç edhe po ndodhë me theksua se padia është hedhur poshtë. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase vlerëson se të njëjtat janë të pa bazuara dhe pa ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Sepse, aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 209 pika b) të LPK-së dhe nenit 63 të LKA-së, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.544/2023, me datë 14.02.2024

Kryetari i kolegjit,

Ramiz Kuqi